



Në bazë të nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 8 pika 6.3 të Ligjit mbi Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës Nr. 04/L-144 dhe Rregullores së Qeverisë së Republikës së Kosovës – QRK nr. 23/2013, për përcaktimin e procedurave të shfrytëzimit dhe këmbimit të pronës së paluajtshme komunale neni 6.1 dhe nenit 5 të Statutit të komunës së Rahovec, Kuvendi i Komunës së Rahovecit, në mbledhjen e mbajtur më 30 Mars 2016, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet kërkesa e Komisionit vlerësues të ofertave i formuar në bazë të vendimit të KK Rahovec, 01 nr. 2290 të datës 30.05.2014, për caktimin çmimit fillestar për shpalljen e ankandit publik të (5) pesë vikend shtëpizave të “Ura e shenjtë” në Xërxe dhe atë në lartësi prej 0.50 €/m².
- II. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Komisioni vlerësues i ofertave i komunës së Rahovecit.
- III. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në mbështetje të nenit 81, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe nenit 18 të Rregullores Nr. -01/2013, për procedurën e hartimit dhe publikimit të akteve të Komunave dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen e Komunës

01 Nr. 913

Rahovec, 30.03.2016

Kuvendi i Komunës së Rahovecit

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odeljenje za Opštu Upravu

Nr. I prot. 913 Më 30.03.2016
Br. prot. Dt. 30.03.2016
RAHOVEC - ORAHOVAC



Kryesuesi i Kuvendit

Nahit Elshani